



Zyrat tona:

Zyra qendrore e Fondacionit Freskia është në Prishtinë.

Adresa: Rr. Shaban Polluzha, Nr. 10.

Kontakti:

Mob:

+383 45 212-600

+383 45 100-231

E-Mail:

fondacioni.freskia@gmail.com

Ueb:

www.fondacionifreskia.org

Facebook:

@FondacioniFreskia

Bank Details:

BANK NAME: Nib bank

SWIFT CODE: NLPR XK PR

IBAN: XK051701001600074675

BENEFICIARY NAME: FONDACIONI FRESKIA

**FONDACIONI
Freskia**

Trajnime avancuese

045 212 600 www.fondacionifreskia.org

SWIFT CODE: NLPR XK PR
IBAN CODE: XK051701001600074675



Trajnime avancuese

Emir i projektit	Trajnime avancuese
Kategoria	Mirëqenie sociale
Përshkrimi	<ul style="list-style-type: none">- Ofrimi i trajnimeve avancuese dhe profesionale me qëllim vetëpunësimi.- Ofrimi i kurseve profesionale me qëllim punësimi.
Arsyeshmëria e projektit	<ul style="list-style-type: none">- Pamundësia e aftësimit profesional për shkaqe ekonomike.- Pamundësia e shkollimit për shkak të rrethanave familjare.- Shkalla e lartë e varfërisë në shoqëri.
Synimet	<ul style="list-style-type: none">- Ofrimi i trajnimeve profesionale për nënat vetushqyese.- Ofrimi i trajnimeve profesionale për komunitetet pakicë.- Ofrimi i trajnimeve profesionale dhe përgatitja për tregun e punës.
Premisat e suksesit	<ul style="list-style-type: none">- Përvoja e ekipit realizues në fushën përkatëse.
Rezultatet e pritshme	<ul style="list-style-type: none">- Aftësimi profesional dhe përgatitja e tyre për vetëpunësim.- Participimi në uljen e shkallës së papunësisë.- Ndihmë e drejtpërdrejt në uljen e shkallës së varfërisë.
Shtresat përfituese	<ul style="list-style-type: none">- Familjet nën asistencë sociale.- Familjet me fëmijë jetim.- Familjet me kushte të rënda ekonomike.- Komunitetet pakicë.
Periudha e realizimit	Përgjatë tërë vitit
Numri i përfituesve	120 kursiste në vit (30 kursiste për çdo 3 muaj)
Kostoja e projektit	18000€ (120 X 150€ = 18000€)
Ekipi realizues	Fondacioni Freskia



*“Një kokërr gruri nuk e mbush dot hambarin,
por ndihmon kokrrat e tjera për ta mbushur”.*
Sami Frashri

Kush jemi ne...

E ngritur mbi parimet bazike humanizmit, solidarizimit dhe shërbimit ndaj të gjithëve, **“Fondacioni Freskia”** është (N.G.O) kosovare.

U themeluar në vitin 2015, dhe u regjistrua në përputhje me ligjet për O.J.Q-të e Republikës së Kosovës. Mbanë nr. të regjistrimit: **5200337-7**.

Fondacioni drejtohet nga një grup aktivistësh vullnetarë, që si vizion dhe preokupim kanë mirëqenien e shoqërisë kosovare.

Mbështetjen kryesore e ka nga Institucionet dhe donatorët vendorë, por një mbështetje e tillë nuk mungon as nga mërgata jonë mbarë shqiptare.

Vizioni:

Fondacioni Freskia vepron me një vizion shumë të qartë.

Është një derë e hapur për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallime etnike, fetare, gjinore apo racore.

Fondacioni Freskia mëton gjetjen e mënyrave adekuate për përmirësimin e gjendjes sociale të kategorive me nevoja të veçanta. Preokupimi ynë kryesorë është shkalla e lartë e papunësisë si dhe gjendja e rëndë socio-ekonomike, prandaj i tërë fokusi ynë është në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Misioni:

Fondacioni Freskia është një fondacion vendor që synon shtresat më nevoja të veçanta dhe ato që janë në një gjendje të rënd socio-ekonomike.

Këtë mundohet që ta realizojë përmes implementimit të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme me karakter humanitar, vullnetarë dhe solidarizues me të tjerët. Misioni ynë parësorë është të qenit urë-lidhëse në mes të Institucioneve, Organeve gjegjëse, donatorëve, vullnetmirëve, dhe bamirësve nga njëra anë, si dhe nevojtarëve, skamnorëve, bonjakëve, të sëmurëve, dhe njerëzve me nevoja të veçanta nga ana tjetër. E tërë kjo synohet që të arrihet përmes metodave, praktikave dhe efikasitetit sa më të lartë.

Objektivat:

Fondacioni Freskia synon të realizojë objektivat e saja si vijon:

- Ofrimi i strehimit dhe përmirësimi i kushteve të banimit.
- Mbështetje financiare dhe sociale për fëmijët jetim dhe familjarët e tyre.
- Mbështetje me ndihma periodike për familjet në nevojë.
- Ofrimi i mundësive për Nënata Vetushqyese dhe inkuadrimi sa më denjësisht në shoqëri.

Ndërsa për një mundësi sa më të mirë të realizimit të këtyre objektivave, në kuadër të Fondacionit Freskia veprojnë tre sektorë të ndryshëm:

- Sektori i Jetimëve
- Sektori i Gruas
- Sektori i ndihmave periodike

Projektet:

Fondacioni Freskia tërë punën e saj e ka të mbështetur në projekte të ndryshme me karakter human. E që përmes implementimit dhe realizimit të këtyre projekteve mundohet që të realizojë edhe qëllimet e saja.

Projektet e Fondacionit Freskia janë të ndara në katër fusha kryesore:

-Mirëqenie sociale, ku bëjnë pjesë projekte si bursë për jetimët, çanta shkollore, kulm për të pastrehët, pakoja humanitare, kurbanet, etj.

-Përkujdes shëndetësorë, ku bëjnë pjesë projekte si vizita mjekësore, vizita familjare rehabilituese, sigurimi i barërave, etj.

-Aftësi profesionale, ku bëjnë pjesë projekte si kurse artizanale, kurse aftësuese, kurse përgatitore, etj.

-Ndihma periodike, ku bëjnë pjesë projekte si ofrimi i druve për ngrohje, ofrimi i veshmbathjeve, ofrimi i ndihmave emergjente në rast të ndonjë fatkeqësie natyrore, etj.